

#### Shtojca 4. Sistemi i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS) i Projektit të Qyteteve të Gjëlbra

##### Fjalorth

|        |                                                                                           |
|--------|-------------------------------------------------------------------------------------------|
| TMM    | Teknika më e Mirë e Mundshme                                                              |
| KTNSRR | Konventa mbi Tregtinë Ndërkombëtare mbi Speciet e Rrezikuara të Faunës dhe Florës së Egër |
| OSHC   | Organizata e Shoqërisë Civile                                                             |
| BERZH  | Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim                                                |
| TP     | Tejkalim i Përputhshmërisë                                                                |
| KE     | Komisioni European                                                                        |
| KEE    | Komuniteti Ekonomik European                                                              |
| BE     | Bashkimi European                                                                         |
| PVMS   | Plan Veprimi Mjedisor dhe Social                                                          |
| KSHE   | Kompania e Shërbimit të Energjisë                                                         |
| DQM    | Departamenti i Mjedisit dhe Qëndrueshmërisë                                               |
| KDMS   | Kujdesi i Duhur Mjedisor dhe Social                                                       |
| VNMS   | Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social                                                  |
| SSMMS  | Sistemi i Strukturës së Menaxhimit Mjedisor dhe Social                                    |
| SMMS   | Struktura e Menaxhimit Mjedisor dhe Social                                                |
| PMMS   | Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social                                                    |
| SMMS   | Sistemi i Menaxhimit Mjedisor dhe Social                                                  |
| PMS    | Politika Mjedisore dhe Sociale                                                            |
| SQMS   | Struktura e Qëndrueshmërisë Mjedisore dhe Sociale                                         |
| BE     | Bashkimi European                                                                         |
| EENK   | Eficienca e Energjisë dhe Ndryshimi Klimatik                                              |
| M&S    | Mjedisor dhe Social                                                                       |
| PP     | Përputhje e Plotë                                                                         |
| NF     | Ndërmjetës Financiar                                                                      |
| IRJ    | Ish-Republika e Jugosllavisë                                                              |
| PVQGJ  | Plan Veprimi i Qytetit të Gjëlbrë                                                         |
| FKGJ   | Fondi i Klimës së Gjëlbrë                                                                 |
| PBB    | Produkti i Brendshëm Bruto                                                                |
| PMN    | Praktika e Mirë Ndërkombëtare                                                             |
| INF    | Institucion Ndërkombëtar Financiar                                                        |
| KFN    | Korporata Ndërkombëtare Financiare                                                        |
| OND    | Organizata Ndërkombëtare Detare                                                           |
| km     | Kilometër                                                                                 |
| TKP    | Tregues Kryesor Performance                                                               |
| PRJ    | Plani i Restaurimit të Jetesës                                                            |
| MARPOL | Konventa Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjeve nga Anijet                             |

|                     |                                                   |
|---------------------|---------------------------------------------------|
| MM                  | Mospërputhje Materiale                            |
| MM                  | Memorandum Mirëkuptimi                            |
| JA                  | Jo e aplikueshme                                  |
| NB                  | nota bene                                         |
| OP                  | Opinioni i Pamundur                               |
| PP                  | Përputhje Pjesore                                 |
| DP                  | Dyfenil i Polikronizuar                           |
| MAP                 | Mekanizmi i Ankesave të Projektit                 |
| SG                  | Substancë me Grimca                               |
| SDO                 | Substancë e Dëmtimit të Ozonit                    |
| OBEZH               | Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik  |
| PVSH                | Plan Veprimi Shpërnguljeje                        |
| KPSH                | Kuadri i Politikave të Shpërnguljes               |
| DPP                 | Dokument Përmbledhës i Projektit                  |
| PAPI                | Plan Angazhimi i Palëve të Interesuara            |
| KNSJD               | Konventa Ndërkombëtare e Sigurisë së Jetës në Det |
| tCO <sub>2</sub> eq | Ekuivalent i një ton CO <sub>2</sub>              |
| TeR                 | Termet e Referencës                               |

### **Përmbledhje ekzekutive e SMMS**

BERZH ka miratuar një Kuadër tërësor të Qëndrueshmërisë Mjedisore dhe Sociale (SQMS) që përbëhet nga një Politike Mjedisore dhe Sociale (PMS) dhe një paketë me Krite Performance mjedisore dhe sociale. SQMS është e lidhur me INF të tjera siç janë IFC dhe Bankat e Ekuatorit. Gjithashtu BERZH zbaton Procedurat Mjedisore dhe Sociale, të cilat përmbledhin procesin nëpërmjet të cilit stafi i Bankës zhvillon dhe monitoron projektet në përputhje me strukturën e përgjithshme të PMS.

Në përputhje me SQMS të BERZH-it, të gjitha projektet duhet t'i nënshtrohen vlerësimit paraprak mjedisor dhe social, si për të ndihmuar BERZH-in të vendosë nëse do të financohet apo jo projekti dhe, nëse po, edhe për mënyrën me të cilën duhen trajtuar çështjet mjedisore dhe sociale gjatë planifikimit, zbatimit dhe funksionimit të projektit. Gjithashtu, procesi i vlerësimit identifikon mundësitë për avantazhe të tjera mjedisore dhe sociale. BERZH synon që nëpërmjet SQMS, vlerësimit mjedisor dhe social dhe proceseve monitoruese, projektet të krijohen, zbatohen dhe të funksionojnë në përputhje me kërkesat rregullatore dhe praktikë të mira ndërkombëtare.

BERZH-i ka përvojë në zhvillimin e vlerësimeve sociale. Nëpërmjet instrumenteve siç janë studimet dhe grupet e fokusit, mund të identifikohen dhe vlerësohen ndikimet e aktiviteteve në grupet e ndryshme sociale me një vëmendje të veçantë kushtuar grupeve më të ekspozuara. Gjithashtu duhet të identifikohen dhe zbatohen masat përkatëse zbutëse në konsultim me grupet e ndikuara. Më tej, vlerësime të tilla mund të sigurojnë mundësi për përmirësimin e cilësisë sociale ekonomike të jetës së njerëzve, duke kuptuar më mirë aspiratat dhe prioritetet e tyre.

## 1. Sfondi i projektit dhe përshkrimi

### 1.1 Sfondi

Bashkitë luajnë një rol të rëndësishëm në “reagimin global ndaj kërcënimit të ndryshimit të klimës, në kontekstin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe përpjekjeve për të zhdukur varfërinë” siç përmendet në Marrëveshjen e Parisit COP21. Bashkitë në Kaukaz, Lindjen e Mesme, Afrikën Veriore, Azinë Qendrore dhe Evropën Juglindore (“Rajoni i Projektit”) përballen me sfida të ngjashme për të ulur intensitetin e tyre të energjisë dhe karbonit, të cilat tejkalojnë mesataren globale. Për më tepër, ato përballen me një sërë çështjesh mjedisore dhe sociale urgjente, duke nisur nga ndikimet e ndryshimit të klimës deri te përkeqësimi i shëndetit dhe mirëqenies së qytetarëve si rezultat i cilësisë së ulët të ajrit.

Bazuar në mbi 25 vjet përvojë investuese në infrastrukturën bashkiake dhe mjedisore, duke përfaqësuar mbi 700 milionë Euro të investuara dhe 800,000 ton CO<sub>2</sub> të moderuara çdo vit, BERZH ka zhvilluar marrëdhëniet, mjetet dhe ekspertizën për të siguruar një zbatim efektiv të Programit të Qyteteve të Gjelbra.

Programi do të krijojë një ndryshim modeli në planifikimin urban, duke siguruar modele dhe investime që mund të përvetësohen dhe përsëriten nga bashkitë e tjera. Do të ketë një tërësi mundësish për të mësuar dhe transferuar njohuritë brenda dhe ndërmjet bashkive dhe shoqërive të shërbimeve bashkiake. Programi i Qyteteve të Gjelbra iu siguron bashkive metodat kryesore për të bërë përmirësime të rëndësishme dhe pozitive në performancën e tyre mjedisore dhe për të mundësuar krijimin e një shembulli të rëndësishëm dhe të përshtatshëm në botë për të zgjidhur sfidat në rritje në lidhje me ndryshimin e klimës në zonat urbane.

### 1.2 Përshkrimi i Projektit

Projekti i Qyteteve të Gjelbra është planifikuar për të zgjidhur pengesat e shumëfishta me të cilat përballen rajoni i projektit për të arritur objektivat e mëposhtme:

#### Objektivi 1. Ofrimi i mbështetjes së politikës dhe strategjisë

Vendosja e një standardi reference dhe një vizioni për një zhvillim të qëndrueshëm për secilën nga bashkitë përfituese dhe sigurimi i ndihmës për autoritetet bashkiake dhe palëve kryesore të interesit për të marrë vendime bazuar në informacionin e klimës mbi veprimet për të zgjidhur sfidat mjedisore.

- Përgatitja dhe zbatimi i dokumenteve të strategjisë së gjelbër për identifikimin, standardizimin, vendosjen e prioritetëve dhe udhëheqjen e veprimeve të qyteteve të gjelbra.
- Krijimi i ndryshimeve ligjore/rregullatore që nevojiten për të përmirësuar mjedisin mundësues për investime të qëndrueshme, p.sh. duke mbështetur qeveritë për të ndryshuar ligjet e buxhetit kur kjo identifikohet si një pengesë nga qeveria.
- Ofrimi i mbështetjes me politika për barazinë gjinore dhe i mbështetjes së bashkive në prezantimin e parimeve të barazisë gjinore në praktikatat e tyre.

#### Objektivi 2. Lehtësimi dhe nxitja e investimeve në infrastrukturën e qyteteve të gjelbra

- Lehtësimi dhe nxitja e financimit sovran dhe nënsovran për investime në lidhje me zbutjen, përshtatjen dhe fleksibilitetin ndaj ndryshimeve të klimës në sektorët prioritarë, duke përfshirë: eficiencën e energjisë në ndërtesat publike, ujin dhe kanalizimet, transportin urban, rrugët dhe ndriçimin urban, menaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe modernizimin e ngrohjes në qytete.
- Sigurimi i barazisë gjinore më të madhe në aksesin dhe përdorimin e shërbimeve bashkiake.

### **Objektivi 3. Ndërtimi i kapaciteteve të administratorëve bashkiakë dhe palëve kryesore të interesit**

Nëpërmjet një asistence teknike të përcaktuar, Projekti do të ndërtojë kapacitete lokale në fushat e mëposhtme:

- Planifikim strategjik sistematik dhe tërësor në nivel bashkie me fokus zbutjen, përshtatjen dhe fleksibilitetin ndaj ndryshimeve të klimës.
- Rritje e performancës financiare dhe operacionale në nivel bashkiak.
- Themelim dhe menaxhim i zbatimit të mbrojtësve mjedisorë dhe socialë.
- Rritje e ndërgjegjësimit publik dhe shumëfishim i përfitimeve të përbashkëta sociale, ekonomike dhe mjedisore.
- Ndërtim i kapaciteteve të administratorëve bashkiakë dhe palëve kryesore të interesit për të siguruar më shumë barazi gjinore në aksesin në punësim.

### **Objektivi 4. Lehtësimi dhe ofrimi i një plani ku qytetet të kenë akses në tregjet e kapitalit**

- Përgatitja e kontributit strategjik për trajtimin e pengesave të qyteteve në aksesin te tregjet e kapitalit për të mbështetur investimet në infrastrukturë.
- Ndërtimi i kapaciteteve të qeverive vendore dhe palëve të interesit për të siguruar përshtatshmërinë e kushteve dhe proceseve për të tërhequr financimet private.

Për të arritur këto objektiva, Projekti do të kombinojë një mbështetje strategjike dhe politikash, investime infrastrukturore, ndërtim kapacitetesh dhe asistencë teknike për të zgjidhur në mënyrën më të mirë nevojat specifike të bashkive dhe pengesat në treg. Gjithashtu, Projekti i Qyteteve të Gjellbra synon të tregojë veprimet e “njëta por të diferencuara” për të luftuar sfidat e ndryshimeve klimatike dhe mjedisore në bashkitë e rajonit ku do zbatohet Projekti, duke iu siguruar bashkive një qasje gjithëpërfshirëse për të identifikuar, për të vendosur prioritetet dhe zgjidhur sfidat e tyre në kontekstin e një zhvillimi të qëndrueshëm.

Projekti do të zgjidhë pengesat e shumta në treg për të vepruar duke siguruar:

**Komponenti 1. Planet e Veprimit të Bashkive të Gjellbra dhe Dialogu për Politikat:** Përgatitja dhe zbatimi i dokumenteve të strategjisë së gjelbër për të identifikuar, standardizuar dhe vendosur prioritetet dhe drejtuar veprimet e bashkisë për të trajtuar ndryshimet klimatike, duke u përpjekur për të arritur rritje të gjelbër dhe për të zhvilluar ndryshime legjislative ose të politikave.

**Komponenti 2. Investimet infrastrukturore të bashkive të gjelbra:** Lehtësimi dhe nxitja e financimit sovran dhe nën-sovran për investime me qëllim zbutjen, fleksibilitetin e ndikimeve të ndryshimeve klimatike në sektorë prioritarë, duke përfshirë: eficiencën e energjisë në ndërtesat publike, ujin dhe kanalizimet, transportin urban, rrugët dhe ndriçimin urban, menaxhimin e mbetjeve të

ngurta dhe modernizimin e ngrohjes në qytete. Bashkitë nuk do të kufizohen vetëm me financimin e BERZH për këto projekte.

**Komponenti 3. Asistenca teknike dhe krijimi i njohurive:** Rritja e performancës financiare dhe operacionale në nivel bashkiak; krijimi dhe menaxhimi i masave zbutëse ndaj ndryshimit të klimës dhe masave përshtatëse, ekonomike dhe sociale; rritja e ndërgjegjësimit publik dhe promovimi i përfitimeve të përbashkëta sociale, ekonomike dhe mjedisore. Shpërndarja e praktikës së mirë për zhvillimin e qyteteve të gjelbra nëpërmjet ngjarjeve dhe trajnimeve të organizuara, dhe pjesëmarrjes në rrjete urbane globale.

**Komponenti 4. Plan i tregjeve të kapitaleve të gjelbra:** Zhvillimi i instrumenteve dhe aftësive për të tërhequr financimet e sektorit privat për investime të gjelbra, duke përfshirë rritjen e ndërgjegjësimit në mundësitë për angazhim me tregun e kapitaleve për investime të gjelbra, identifikimi dhe kualifikimi i investimeve të pranueshme për financime të gjelbra, dhe mobilizimi i kapitalit nga modalitete të reja.

## 2. Kushtet e pranimit

### 2.1 Qytetet e synuara dhe kushtet e pranimit për të marrë pjesë në Projekt

Bashkitë do të fillojnë përfshirjen e tyre në Projekt me një kombinim të një PVQGJ dhe një nënprojekt investues, referuar si projekti 'nxitës', që përmbush kritere specifike të performancës. Të dyja angazhimet do të shërbejnë si nxitëse për fillimin e përfshirjes së bashkive në Projekt. Bashki të tjera dhe projekte investimi do të shtohen në Projektin e Qyteteve të Gjelbra duke iu nënshtuar kritereve të mëposhtme të pranimit.

Do të kryhet kujdesi i duhur i situatës aktuale përpara se BERZH të miratojë çdo projekt të bashkisë së gjelbër si pjesë e Projektit. Si pjesë e kujdesit të tij të duhur, për çdo nënprojekt, BERZH do të vlerësojë kapacitetet e bashkive dhe kompanive të shërbimeve bashkiake për të zbatuar në mënyrë të suksesshme projektin, dhe në përputhje me politikat e BERZH dhe FKGJ. Vlerësimi i kapacitetit të klientëve për të përmbushur përgjegjësitë mjedisore dhe sociale, dhe zbatimin e projektit në përputhje me Kushtet e Performancës së BERZH, është një pjesë e rëndësishme e Vlerësimit Mjedisor dhe Social të BERZH-it. Kjo përfshin një përmbledhje të politikave Mjedisore dhe Sociale të klientit, sistemeve të menaxhimit dhe burimet në përputhje me Kriterin e Performancës 1, i cili përfshin ndërmjet të tjerave kërkesat për Sistemin e Menaxhimit Social, Planin Mjedisor dhe të Menaxhimit Social, Kapacitetet Organizuese dhe Angazhimit. Në rastet e identifikimit të mangësive ndaj kërkesave të BERZH, në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social do të përfshihen masa për përf forcimin e kapaciteteve organizative. Në rastet kur Klienti ka nevojë për mbështetje, BERZH-i mund të konsiderojë sigurimin e një Asistence Teknike për ndërtimin e kapaciteteve nëpërmjet fondeve të tij të Bashkëpunimit Teknik.

Të paktën 10 bashki priten të ndërmarrin veprimet e mëposhtme gjatë kësaj faze të Projektit:

- zhvillimin e një Plan Veprimi të Qyteteve të Gjelbra (Komponenti 1);
- investim në 1 deri në 4 projekte të infrastrukturës urbane për çdo bashki (Komponenti 2);
- ndërtimin e kapaciteteve institucionale për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe zbatimin e infrastrukturës urbane në mënyrë të përgjegjshme klimatike (Komponenti 3); dhe
- rritja e angazhimit me tregjet e kapitalit, kur është e realizueshme, duke synuar mundësitë për të mbështetur investimet e gjelbra (Komponenti 4).

## 2.2 Kriteret e Performancës për pranueshmërinë e nënprojektit

Si projektet fillestare dhe ato pasuese në zhvillimin e një PVQGJ do të kërkohej të strukturohen në përputhje me kërkesat strikte mjedisore dhe sociale të Bankës, të përcaktuara në Kriteret e performancës për të përmbushur kriteret e mëposhtme mjedisore dhe sociale të vlerësuara nëpërmjet analizave paraprake:

- Të gjitha projektet e investimit me një bashki do të:
  - i) Përmbushin një ose më shumë nga kushtet e mëposhtme për të demonstruar ndikimin e tyre në zbutjen dhe përshtatjen ndaj klimës:
    - Reduktimi i emetimit të gazrave serrë nga veprimtaria përkatëse e bashkisë me të paktën 15%; ose
    - Përmirësimi i eficiencës së energjisë me të paktën 15%<sup>1</sup>; ose
    - Rritja e fleksibilitetit ndaj klimës në përputhje me metrikat dhe pragjet e mëposhtme:

**Tabela 1. Treguesit dhe pragjet e pranimit të fleksibilitetit për investimet në infrastrukturën e qyteteve të gjelbra**

| Risqet e klimës (specifike për kontekstin )                                                                      | Dimensioni i fleksibilitetit                        | Njësia                                                                                                | Pragu për përmirësim |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|
| Rritja e presionit të ujit                                                                                       | Rritja e disponueshmërisë së ujit*                  | m <sup>3</sup> / vit <sup>2</sup>                                                                     | 10%                  |
| Rritja e presionit të nxehtësisë                                                                                 | Rritja e disponueshmërisë së energjisë*             | kWh / vit <sup>3</sup>                                                                                | 15%                  |
| Rritja e presionit të nxehtësisë ose Rritja e kushteve ekstreme atmosferike                                      | Rritja e shëndetit ose produktivitetit të njerëzve* | QALY (vitet e jetës të përshtatura sipas cilësisë)                                                    | 10%                  |
| Rritja e presionit të ujit ose Rritja e kushteve ekstreme atmosferike                                            | Pakësim i ndërprerjeve**                            | Ditë ose orë për vit                                                                                  | 10%                  |
| Rritja e presionit të nxehtësisë ose Rritja e variacionit hidrologjik ose Rritja e kushteve ekstreme atmosferike | Pakësim i dëmit**                                   | DËM I MADH: shpeshtësia e riskut (%)<br>DËM I VAZHDUESH ËM: jetëgjatësia e asetit (vite) <sup>4</sup> | 10% <sup>5</sup>     |

<sup>1</sup> Masat për eficiencën e energjisë dhe emetimin e gazrave serrë do të jenë në përputhje me Manualin e BERZH-it për Tranzicionin e Ekonomisë së Gjelbër për matjen dhe raportimin e ndikimeve mjedisore të projektit, manuali përfshin [Kudrin IFN për Qasjen e Harmonizuar në Llogaritjen e gazrave serrë](#)

<sup>2</sup> Masat për kursimin e ujit do të përdorin metodologjinë e përcaktuar në Manualin e BERZH-it për Tranzicionin e Ekonomisë së Gjelbër

<sup>3</sup> Në bazë të kujdesit të duhur specifik të projektit duke përdorur një metodologji bazë të përcaktuar në [Kudrin IFN për Qasjen e Harmonizuar në Llogaritjen e gazrave serrë](#)

<sup>4</sup> Masat për vitet e jetës të përshtatur sipas cilësisë, ditët ose orët e ndërprerjes për vit, dhe dëmi i madh ose i vazhdueshëm do të bazohen në kujdesin e duhur, duke përdorur praktikën më të mirë të industrisë për sektorë specifikë.

\*në kontekstin e cenueshmërisë së ndryshimit/variacionit

\*\*p.sh. ndërprerja/dëmi i lidhur me kushtet atmosferike

- ii) Jenë pjesë e sektorëve të infrastrukturës bashkiake, duke përfshirë përmirësimet në transportin urban, ngrohjen në qytete, ujin dhe kanalizimet, ndriçimi rrugor, menaxhimi i mbetjeve të ngurta ose eficiencën e energjisë dhe modifikimet në ndërtesa;
- iii) Garantojnë se veprimtaritë e financuara për përshtatjen nuk do të çojnë në rritjen e emetimeve të gazrave serrë;

- Gjithashtu:

- Të gjitha projektet për investimet fillestare me një bashki do të angazhohen: i) në zhvillimin e një PVQGJ-je bazuar në metodologjinë e PVQGJ-së, dhe ii) përcaktimin e një stafi përgjegjës nga bashkia për procesin e zhvillimit dhe zbatimit të PVQGJ-së.
- Të gjitha investimet pasuese për zhvillimin e një PVQGJ-je dhe zbatimin e projekteve fillestare do të adresojnë një sfidë<sup>6</sup> mjedisore prioritare të identifikuar nga PVQGJ specifik i bashkisë. Sfidat mjedisore prioritare do të përzgjidhen nga bashkia midis treguesve të PVQGJ që matin performancën mjedisore urbane.
- Të gjitha investimet për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, që janë pjesë e Projektit, do të zhvillohen dhe vlerësohen duke përdorur një proces të qëndrueshëm për vlerësimin e riskut klimatik. Kjo do të përdoret sa herë që të jetë e mundur për qasje ekzistuese të mirëkrijuara, si metodologjia me tre hapa e studimit të përshtatjes financiare nga Grupi i Financimeve Klimaterike MDB, dhe rregullorja EUFIWACC për zhvillimin e projekteve për përshtatjen e ndryshimeve klimaterike. Në këtë mënyrë konteksti i impaktit klimaterik për çdo investim të propozuar do të përcaktohet qartë dhe do të vlerësohet si i ulët, i mesëm ose i lartë. Ky proces do të përdoret për të përcaktuar nëse investimet e propozuar përmbushin kriteret kualifikuese të GrCF për projekte të përshtatjes së ndryshimeve klimaterike.

### *2.3 Ndikimet dhe risqet e mundshme mjedisore dhe sociale të nënprojekteve dhe masat lehtësuese*

Projekti dhe veçanërisht procesi i Planit të Veprimit të Qyteteve të Gjelbra janë ndërtuar mbi modelin e vlerësimit strategjik mjedisor dhe kanë objektiva të ngjashme të përmbledhura në një dokument që artikulon vizionin e Gjelbër të Bashkisë, objektivat strategjike, investimet dhe veprimet prioritare për të zgjidhur sfidat kryesore mjedisore që ndikojnë në mënyrë efektive në arritjen e objektivave mjedisore të Bashkisë. Për më tepër, procesi i PVQGJ reflekton hapat strategjikë të procesit të vlerësimit mjedisor nga kuadri bazë deri te përfitimet sociale dhe mjedisore specifike të nënprojekteve, risqet dhe ndikimet e palëve të angazhuara deri në përcaktimin e veprimeve prioritare. Kjo qasje strategjike që bashkon kërkesat mjedisore dhe sociale, dhe përfshirjen e palëve të interesuara në përzgjedhjen e projekteve me prioritet gjatë gjithë procesit, në vetvete do të kontribuojë në mënyrë efektive në shmangien ose minimizimin e risqeve mjedisore dhe sociale që lidhen me projektet prioritare. Kjo do të plotësohet nga vlerësime sociale dhe mjedisore specifike të nënprojekteve, të cilat do të specifikojnë masat e nevojshme lehtësuese për të strukturuar projektet në mënyrë që ato të përmbushin rezultatet e qëndrueshme të përcaktuara në Kriteret e Performancës së BERZH-it.

<sup>5</sup> Vlerat e pragut për vitet e jetës të përshtatur sipas cilësisë, ditët ose orët e ndërprerjes për vit, dhe dëmi i madh ose i vazhdueshëm mund të përditësohen si praktikë e mirë në përmirësimin e monitorimit të fleksibilitetit

<sup>6</sup> Një sfidë mjedisore prioritare është identifikua në metodologjinë e PVQGJ-së duke përdorur treguesit dhe kontributin e palëve të interesit. Në disa raste, është e mundur që kontributi i palëve të interesit të mund të identifikojë një sfidë mjedisore prioritare për qytetin e tyre ku treguesi përkatës nuk raporton probleme (p.sh. ku treguesi performon më mirë sesa standardet mjedisore ndërkombëtare). Në këtë rast, çdo projekt që trajton një sfidë të tillë mjedisore prioritare do të justifikohet rast pas rasti.

Nënprojektet pritet të jenë kryesisht në sektorët me prioritet ku përfshihen: efienca e energjisë së ndërtesave publike dhe rezidenciale, ujërat dhe kanalizimet, transporti urban, rrugët dhe ndriçimi urban, menaxhimi i mbetjeve të ngurta dhe ngrohja e qytetit. Nënprojektet me prioritet kërkohen të përmbushin kriteret të larta të performancës mjedisore (siç përcaktohet më lart) dhe do të rezultojnë kryesisht në përfitime të rëndësishme mjedisore, dhe zakonisht shoqërohen me risqe mjedisore dhe sociale të limituara dhe të përkohshme për modernizimin ose punimet ndërtuese. Ndikimet dhe risqet mjedisore të mundshme zakonisht kanë origjinë të ndryshme të varur nga fakti nëse projekti përfshin modernizimin e strukturës ekzistuese apo ndërtimin ose instalimin e strukturave të reja:

- Për nënprojektet që përfshijnë modernizimin dhe përmirësimin e projekteve ekzistuese, ku nuk kërkohet ndryshim i përdorimit të truallit, këto risqe pritet të jenë specifike sipas vendit dhe masat lehtësuese mund të jenë më të shpejta duke zbatuar praktikatat e mira ndërkombëtare.
- Për nënprojektet që përfshijnë ndërtimin e instalimeve të reja, si rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimeve, ose sistemin ngrohës të qytetit, rrugët e reja urbane, impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura të përmasave të mëdha, impiantet ngrohëse të qytetit apo struktura për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, duhet t'iu kushtohet një vëmendje e veçantë kufizimeve të planifikimit territorial që mund të lindin nga zbatimi i projekteve të tilla në një mjedis urban. Këto lloj projektesh mund të kërkojnë një proces angazhimi të palëve të interesuara për të identifikuar zgjidhjen optimale, veçanërisht në lidhje me vendndodhjen dhe mënyrat efektive për të shmangur, minimizuar ose lehtësuar ndikimet dhe risqet e mundshme mjedisore dhe sociale që lindin nga ndryshimet në përdorimin e truallit. Angazhimi efektiv dhe kuptimplotë i palëve të interesuara do të jetë faktor kryesor në identifikimin dhe zgjidhjen e shqetësimeve të banorëve të zonës.

Për të dyja llojet e projekteve do të përgatiten plane veprimi për të rënë dakord mbi masat specifike për të shmangur ose lehtësuar ndikimet dhe risqet e mundshme mjedisore dhe sociale.

### 3. Konteksti Urban, Mjedisor dhe Social

#### 3.1 Konteksti Urban

Rajonet urbane në Evropën Juglindore përballen me sfida të ngjashme, shumë prej të cilave përfshijnë përdorimin e energjisë. Në qytetet e Serbisë ka një potencial veçanërisht të madh për përmirësimin e eficiencës së energjisë. Një potencial i tillë është më i lartë se në shumë vende të tjera të rajonit ku vepron BERZH për shkak të mirëmbajtjes jo të rregullt të ndërtesave dhe pajisjeve industriale (veçanërisht në zonat publike), si edhe falë ekzistencës së një stoku të madh pajisjesh që kanë tejkaluar kohën e tyre ekonomike dhe fizike. Kjo ka shkaktuar rritjen e çmimeve të energjisë, pajisjeve të vjetra dhe joefektive industriale, si edhe mungesën e pajisjeve matëse dhe kontrolluese. Një rritje e tillë e çmimit të energjisë krijon rritje të mëtejshme të kostove të bizneseve dhe pronarët/administratorët e ndërtesave që po sfidohen ndërkohë nga klima ekonomike aktuale. Përmirësimi i eficiencës së energjisë është një përgjigje efektive ndaj kësaj sfide.

Rajonet urbane në Shqipëri përballen me sfida të ngjashme në faktin që ndërtesat rezidenciale dhe ato publike janë shpesh joeficiente, të cilat hapin mundësi për investime të uljes së kostos së energjisë. Për më tepër, Shqipëria dhe qytetet e saj varen plotësisht në importe dhe hidrocentrale për të përballuar kërkesat e saj për energji elektrike, ndërkohë që Shqipëria akoma ka ndërprerje të energjisë më tepër se shtetet e tjera në Evropën Juglindore. Prodhimi i padiversifikuar i energjisë

shoqërohet nga kërkesa serioze për investime për përshtatje ndaj klimës, sepse prodhimi nëpërmjet energjisë hidrike parashikohet të ndikohet nga zhvendosje me bazë klimatike në hidrologji dhe pakësim të ujërave sipërfaqësore.

Në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, nivelet e ndotjes së ajrit janë ndër më të lartat në Evropë dhe ndikojnë në probleme serioze të shëndetit publik. Kjo është më e theksuar në zonat urbane me më tepër se 45% të ndikimeve në shëndet të ndodhura vetëm në Shkup. Pjesa më e madhe e kësaj ndotjeje shkaktohet nga infrastruktura e energjisë dhe transporti ku pajisje dhe procese të vjetruara dhe një flote makinash të vjetruara ndikojnë në rritjen e nivelit të ndotjes. Transporti veçanërisht çliron gaze në mënyrë intensive krahasuar me shtetet e tjera për arsye të kushteve të makinave dhe gjendjes së keqe të rrjetit rrugor dhe transportit. Pronësia e makinave personale është në rritje, veçanërisht në qytete, të cilat kategorizohen nga shtrirje të mëdha urbane dhe përdorim joeficient të tokës. Këto modele zhvillimi kanë ndikuar në furnizim të çrregullt me ujë, mbledhjen e mbetjeve të ngurta dhe furnizimin me energji, mungesën e përpunimit të ujërave të zeza dhe një përdorim të limituar të transportit publik.

Në Moldavi, veçanërisht ndërtesat e banimit janë shumë joeficiente. Sektori i banesave në Moldavi është përdoruesi më i madh me afërsisht 40% të konsumit të energjisë përfundimtare kombëtare dhe rreth 70% e konsumit të energjisë në banesa vetëm për ngrohjen e hapësirave. Megjithatë, pengesat e tregut për investime në projekte të energjisë së qëndrueshme, si në sektorin industrial dhe në atë rezidencial, janë shumë të larta në Moldavi në të gjitha nivelet.

Në Tunizi, konsumatori më i madh i energjisë elektrike është sektori industrial me 36%. Ekzistojnë pengesa të ndryshme për rritjen e eficiencës së energjisë, përfshirë mungesën e ndërgjegjësimit, kapacitetet e vogla teknike dhe mungesën e besimit ndërmjet palëve të interesuara (si KSHE, bankat, kompanitë industriale dhe autoritetet e qeverisë). Për më tepër, Tunizia mbetet e pazhvilluar në menaxhimin e mbetjeve dhe eficiencën e burimeve, dhe si rrjedhim 85% e mbetjeve të ngurta të bashkive përfundon në landfillet dhe më pak se 1 % riciklohet.

Qendrat e qyteteve në rajonin e Kaukazit, specifiku në Armeni dhe Gjeorgji kanë trashëguar një grup divers rrjetesh të vjetruara të transportit publik. Një qytet tipik me rrjete të konsoliduara me trame, autobusë elektrikë dhe autobusë, qytetet e ditëve të sotme përpiqen shumë të mirëmbajnë rrjetet ekzistuese të Shërbimit, duke lënë mënjane mundësinë për financim të modernizimit ose zgjerimit të rrjeteve të reja të transportit publik. Mungesa serioze e mirëmbajtjes që në vitet 1990 ka shkaktuar një mbyllje pjesore të sistemeve publike të transportit në të gjithë rajonin.

Në rajonet urbane mongole, legjislacioni rregullator për infrastrukturën bashkiake është i dobët dhe ndërhyrja politike në procesin rregullator vazhdon të jetë dominante. Sistemet e matjes janë të rralla dhe faturimi i bazuar në përdorimin aktual pothuajse nuk ekziston duke krijuar pak nxitje për një përdorim eficient. Për sa i përket sektorit të transportit, mbizotëron një shërbim autobusësh të vegjël private të pakontrolluar që janë shumë përfituese. Megjithatë, ka një kapacitet të limituar për rinovimin e flotës pothuajse të amortizuar. Probleme me të përgjithshme janë kostot joeficiente (menaxhimi jokorrekt dhe caktimi i punonjësve, përdorimi i madh i energjisë), mbledhja e vogël e të ardhurave (nivele të ulëta arkëtimesh), humbje të mëdha të furnizimit me ujë dhe cilësia e ulët e ujit.

Në Jordani përqindja e njerëzve që jetojnë në zonat urbane është rreth 83 për qind. Kjo është një nga nivelet më të larta në të gjitha vendet e mbuluara nga Projekti. Ndërsa Jordania ka nivelet më të ulëta

të disponueshmërisë së ujit në botë, gjithashtu rajonet e tij urbane kanë një infrastrukturë të keqe të ujit. Është vlerësuar që rrjetet e shpërndarjes së ujit të humbin mesatarisht 68 për qind të furnizimit me ujë si rezultat i rrjedhjes nga tubacionet dhe sistemeve të papërshtatshme të matjes. Autoritetet që janë përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe zëvendësimin e rrjetit të ujit nuk kanë mekanizmat e duhur për mbulimin e kostove, ndërkohë që kostot e ujit janë në nivele shumë të ulëta në krahasim me tregjet e krahasueshme.

### 3.2 Konteksti Mjedisor dhe Social

Pjesët përbërëse të Projektit i përgjigjen në mënyrë të drejtpërdrejte sfidave mjedisore dhe sociale në rajonin ku do zbatohet Projekti. Rajoni ku do zbatohet Projekti karakterizohet nga një përdorim energjie në mënyrë joeficiente, probleme mjedisore të rëndësishme si ndotja e ajrit, intensiteti i lartë i çlirimit të karbonit (tCO<sub>2</sub>eq/GDP) – me disa vende që kanë rreth tetë herë më të lartë intensitet karboni sesa mesatarja globale. Ky përdorim joeficient i energjisë reflektohet në një performancë të ulët energjie në ndërtesat publike dhe private në zonat urbane.

Menaxhimi i mbetjeve është një problem mbizotërues, i cili ndikon ndjeshëm në çlirimin e GHG nëpërmjet rrjedhjeve të metanit nga zonat e vjetra të landfilleve. Shumë qytete në rajonin ku operonë BERZH-i prodhojnë mbetje të ngurta në nivele shumë më të larta për person në vit sesa mesatarja e BE. Për shembull, në Gjeorgji këto nivele janë sa dyfishi i mesatares së BE. Shumë prej këtyre mbetjeve përfundojnë në landfille që janë “zona periferike ku shërbimet bashkiake (ose kontraktuesit) vetëm i grumbullojnë ose depozitojnë mbetjet”. Për më tepër, riciklimi i mbetjeve në zonat urbane të rajonit të Projektit është i papërfillshëm krahasuar me një mesatare të BE në rreth 39 për qind dhe një objektiv të BE në rreth 50 për qind të riciklimit të mbetjeve të ngurta bashkiake në vitin 2020.

Për më tepër, banorët e disa qyteteve në rajon janë të ekspozuar ndaj niveleve shumë më të larta të ndotjes së ajrit në qytet sesa pjesa tjetër e popullsisë. Sipas Bankës Botërore (2015), 100 për qind e popullsisë qytetare në Jordani është e ekspozuar ndaj niveleve të larta të rrezikut (PM<sub>2.5</sub>) që i tejkalojnë udhëzimet e OBSH, krahasuar me një mesatare në botë prej rreth 92 për qind.

Infrastruktura urbane e përkeqësuar dhe e vjetruar në rajonin e Projektit po ulin cilësinë e jetës duke përkeqësuar shkaqet e ndryshimeve klimatike, dhe duke mos i lejuar komunitetet të përshtaten ose përmirësojnë fleksibilitetin. Megjithatë, barriera të ndryshme pengojnë zhvillimin e planit të qytetit të gjelbër dhe investimeve infrastrukturore. Këto përfshijnë:

- Mungesën e një qasjeje sistematike dhe tërësore për të adresuar ndryshimet klimatike në planifikimin urban. Megjithëse qeveri të ndryshme janë përpjekur të zgjidhin problemet e qëndrueshmërisë urbane, këto përpjekje janë prirur të kryhen rast pas rasti duke u varur nga kërkesa e administratave të bashkive. Ajo çfarë nevojitet është një program sistematik dhe tërësor për zhvillimin e një qyteti të gjelbër që mund të plotësojë kompleksitetin e qëndrueshmërisë urbane.
- Pengesat ligjore dhe rregullatore përfshijnë mungesën e nxitjeve të politikave ose instrumenteve në nivel bashkiak dhe tarifave të ulëta të energjisë për të stimuluar kërkesën e veprimtarisë së gjelbër dhe investimeve.

- Pengesat financiare përfshijnë mungesën e aksesit në financim, mungesën e vendosjes së një çmimi të duhur (përqindje interesi dhe afat) për të nxitur investime, problematika e përballueshmërisë së qytetareve, kushtet e FMN-së për të limituar borxhet jokoncensionare, kostot e larta të teknologjive me performancë të lartë dhe mungesa e buxheteve për studime fizibiliteti dhe auditimeve të energjisë.
- Pengesat teknike, veçanërisht mungesa e kapaciteteve në bashki në lidhje me: përvojën dhe aftësitë në vlerësimin e mundësive të investimeve në infrastrukturën e gjelbër, njohuritë teknike, burimet njerëzore dhe organizimet institucionale të përshtatshme.
- Mungesa e ndërgjegjësimit ndërmjet palëve të interesuara lokale për përfitimet e programit të qyteteve të gjelbra dhe përfitimet e tyre të përbashkëta sociale, ekonomike dhe mjedisore.
- Mungesa e kapaciteteve ndërmjet organizatave të shoqërisë civile (OSHC) për një komunikim/shpërndarje efektive dhe transferim njohurish që do t'i mundësojë atyre që të arrijnë të kontaktojnë në mënyrë efektive popullsinë e zonave të tyre të zgjedhore/urbane në përgjithësi, e të rrisin ndërgjegjësimin publik dhe të promovojnë në mënyrë efektive pjesëmarrjen publike dhe ndryshime pozitive në sjellje.
- Mungesa e aksesit në kapital për investime në infrastrukturë. Qytetet kanë vështirësi në sigurimin e kapitalit, veçanërisht nga burime private, për të financuar projektet në infrastrukturë për shkak të një larmie faktorësh, duke përfshirë: kostot e larta të kapitalit fillestar dhe kanë periudha të gjata shlyerjeje për investimet në infrastrukturë krahasuar me sektorët e tjerë; mungesa e vlerësimeve të aftësisë për të paguar dhe tregjet vendore të kapitalit jo të zhvilluara mjaftueshëm.

#### 4. Sistemi i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS)

BERZH do të zbatojë Kuadrin e Qëndrueshmërisë Mjedisore dhe Sociale (KQMS) gjithëpërfshirëse për këtë Program. KQMS e BERZH-it bazohet në mandatin mjedisor dhe të Qëndrueshmërisë në Nenet e themelimit të BERZH-it, në Politikën Mjedisore dhe Sociale (PMS), Kriteret e Performancës të përditësuara rregullisht dhe një Departament Mjedisor dhe të Qëndrueshmërisë të dedikuar, i ngarkuar me përgjegjësinë e zbatimit të tij dhe departamente të dedikuara të Gjinisë dhe Eficiencës në Energji dhe Ndryshimit të Klimës (E2C2) të mandatuara për të identifikuar në mënyrë sistematike mundësitë mjedisore, sociale dhe që lidhen me gjininë. BERZH-i është akredituar nga Bordi i FKGJ në shtator 2015. Versioni i fundit i PMS dhe Kriteret e saj të Performancës janë miratuar nga Bordi i Drejtorëve të BERZH-it në 7 maj 2014. PMS është rishikuar për të siguruar që BERZH qëndron për krah IFN të tjera siç janë KFN dhe Bankat e Ekuatorit për të adresuar çështje që kanë lindur gjatë zbatimit të PMS së mëparshme të vitit 2008 dhe për të identifikuar një numër çështjesh që mund të shfaqen mbi qëndrueshmërinë. Rishikimet në PMS u shoqëruan me konsultime të gjera me palët e interesuara duke përfshirë organizatat e shoqërisë civile, shoqatat industriale, klientët, institucione të tjera financiare ndërkombëtare dhe organizata ndërkombëtare. SMMS është përshkruar me detaje në Procedurat Mjedisore dhe Sociale, që u përditësuan në 2015 <http://www.ebrd.com/what-we-do/strategies-and-policies/environmental-procedures.pdf>, dhe të cilat përshkruajnë procesin nëpërmjet të cilit stafi i Bankës përpunon dhe monitoron projektet në përputhje me kuadrin e përgjithshëm të PMS-së.

Në përputhje me KQMS të BERZH, të gjitha projektet i nënshtrohen një vlerësimi mjedisor dhe social për të ndihmuar BERZH në marrjen e vendimit nëse projekti duhet të financohet dhe nëse po, mënyrën se si çështjet mjedisore dhe sociale do të zgjidhen në planifikimin, zbatimin dhe operimin e tij. Gjithashtu, procesi vlerësues identifikon mundësitë për përfitime të tjera mjedisore ose sociale. BERZH kërkon në përputhje me mandatin e saj të sigurojë nëpërmjet vlerësimit mjedisor dhe social

dhe proceseve monitoruese që projektet të planifikohen, zbatohen dhe operojnë në përputhje me kërkesat rregullatore të aplikueshme dhe praktiken e mirë ndërkombëtare.

Të gjithë projektet e këtij Programi do të kategorizohen dhe strukturohen për të përmbushur Kriteret e Performancës së BERZH. Këto detajohen më poshtë. Një monitorim gjithëpërfshirës, gjithashtu i përshkruar më poshtë do të kryhet nga BERZH dhe konsulentët teknikë të cilët zbatojnë mbështetjen për projektin. Raportimi të FKGJ do të bazohet në rezultatet e këtij monitorimi.

## **5. Kriteret e Performancës, përjashtimet dhe përputhja me Ligjet dhe Rregullat Përkatëse**

### *Te përgjithshme*

BERZH kërkon që projektet e saj të përmbushin Praktiken e Mirë Ndërkombëtare në lidhje me qëndrueshmërinë mjedisore dhe sociale. Për të ndihmuar klientët dhe/ose projektet e tyre të arrijnë këtë, BERZH ka përcaktuar Krite Performance (KP) specifike për fushat kryesore të qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale. BERZH ka përshtatur 10 KP, të cilat janë në përputhje dhe reflektojnë strukturën e përgjithshme, trajtojnë dhe mbulojnë çështje të Standardeve të Performancës së KNF 2012, ndërkohë që iu kërkohet projekteve veçanërisht të plotësojnë standardet mjedisore të BE.

### *Kriteret Specifike të Performancës*

Dhjetë Kriteret e Performancës së BERZH janë:

- KP 1 - Vlerësimi dhe Menaxhimi i Çështjeve dhe Ndikimeve Mjedisore dhe Sociale
- KP 2 - Kushtet e Punës
- KP 3 - Efienca e Burimeve, Kontrolli dhe Parandalimi i Ndotjes
- KP 4 - Shëndeti dhe Siguria
- KP 5 - Marrja e Tokës, Shpërngulja e Detyruar dhe Zhvendosja Ekonomike

KP 5 përcakton një Kuadër të Politikave të Shpërnguljes (KPSH) që aplikohet në të gjitha projektet e BERZH, të cilat përfshijnë marrjen e tokës ose ndryshimin e përdorimit të tokës, që mund të rezultojë në një shpërngulje të detyruar në formën e një zhvendosjeje fizike (zhvendosje ose humbje të banimit) dhe ose zhvendosjeje ekonomike (humbje të aseteve ose burimeve, dhe/ose humbje të mundësisë së përdorimit të aseteve ose burimeve që rezultojnë në humbje të burimeve të të ardhurave ose mjeteve të jetesës në përputhje me ligjet kombëtare dhe rregullat e shtetit. KPSH e përcaktuar në KP5 synon të:

- shmangë ose kur është e pashmangshme të minimizojë shpërnguljen e detyruar duke eksploruar plane alternative të projekteve;
- lehtësimin e ndikimeve të pafavorshme sociale dhe ekonomike nga marrja e tokës ose kufizime në përdorim nga persona të ndikuar në asetet dhe tokën duke: (i) siguruar kompensim për humbjen e aseteve dhe zëvendësimin e kostos; dhe (ii) duke siguruar që aktivitetet e zhvendosjes të zbatohen me një publikim përkatës të informacionit, konsultim dhe pjesëmarrje të informuar të personave të ndikuar;
- restaurimin, ose ku është e mundur përmirësimin e kushteve të jetesës dhe standardeve të personave të zhvendosur në nivelin përpara zhvendosjes;
- përmirësimin e kushteve të jetesës të personave të zhvendosur fizikisht nëpërmjet ofrimit të strehimeve të përshtatshme, përfshirë sigurinë e zotërimit në vendet e zhvendosura.

KPSH përfshin kriteret përzgjedhëse, kriteret e pranueshmërisë, procedurat e vlerësimit dhe zbatimit, kërkesat specifike konsultuese, marrëveshjet institucionale, metodat vlerësuese, matrica të përgjithshme të së drejtës së zotërimit, mekanizmat e ankimimit dhe monitorimit, planin e pritshëm zhvillues buxhetore të kapaciteteve (ku është e nevojshme). Gjithashtu, KPSH përfshin kriteret dhe procedurat për të zhvilluar një Plan Veprimi Shpërnguljeje.

- KP 6 - Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Burimeve Natyrore
- KP 7 – Popullsia Indigjenë

Në rajonin e Programit nuk ka popullsi indigjenë dhe për këtë arsye nuk pritet të këtë një Kuadër Planifikimi të Popullsisë Indigjenë

- KP 8 – Trashëgimia Kulturore
- KP 9 – Ndërmjetësit Financiarë
- KP 10 - Dhënia e Informacionit dhe Angazhimi i Palëve të Interesit

Çdo KP përcakton në objektivat e saj rezultatin e dëshiruar, shoqëruar nga kriteret specifike për çdo projekt për të ndihmuar klientët që t'i arrijnë këto rezultate. Përputhja me legjislacionin përkatës kombëtar është një pjesë e rëndësishme për të gjitha KP.

KP të plota mund të gjenden në [këtë link](#).

## 6. Kategorizimi

Çdo nënprojekt nën këtë Program do t'i nënshtrohet një përzgjedhje mjedisore dhe sociale, dhe do të kategorizohet si A, B ose C në fazën fillestare të ciklit të projektit, për të përcaktuar llojin dhe nivelin e hetimeve mjedisore dhe sociale, publikimit të informacionit dhe angazhimit të palëve të interesuara. Kategorizimi do të bëhet në përputhje me llojin, vendndodhjen, sensitivitetin, shkallën e projektit dhe domethënien e ndikimeve të mundshme të pafavorshme mjedisore dhe sociale në të ardhmen. Shkaqet kryesore dhe arsyetimet për përcaktimin e kategorisë së projektit do të dokumentohen. Kur ka informacion të pamjaftueshëm për përzgjedhjen dhe kategorizimin, do të kryhet një Studim Mjedisor dhe Social Fillestar për mbledhjen e sasisë së mjaftueshme të informacionit mbi llojin, vendndodhjen, sensitivitetin dhe shkallën e projektit, dhe rëndësinë e ndikimeve të tij të mundshme dhe të pafavorshme mjedisore dhe sociale në të ardhmen, për të dhënë informacion mbi përzgjedhjen dhe për të përcaktuar kategorinë përkatëse dhe qëllimin e hetimeve mjedisore dhe sociale, publikimin e informacionit dhe angazhimit të palëve të interesuara.

Një projekt kategorizohet :

- “A” kur mund të rezultojë në ndikime të rëndësishme jo të favorshme mjedisore dhe/ose sociale në të ardhmen, të cilat në kohën e kategorizimit nuk mund të identifikohen dhe përcaktohen menjëherë dhe për këtë kërkohet një proces i formalizuar pjesëmarrës mbi vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe social. Një listë treguese e projekteve të Kategorisë A është paraqitur në Shtojcën 2 të PMS.

- “B” kur ndikimet e mundshme jo të favorshme mjedisore dhe/ose sociale në të ardhmen janë zakonisht specifike sipas vendit, dhe/ose identifikohen dhe zgjidhen lehtë nëpërmjet masave lehtësuese. Kriteret e vlerësimit mjedisor dhe social mund të ndryshojnë në varësi të projektit dhe do të përcaktohen nga BERZH mbi bazën e vlerësimit specifik e sipas rastit.
- “C” kur ka mundësi të këtyre ndikime minimale ose jo të rëndësishme mjedisore dhe/ose sociale dhe që mund të zgjidhen nëpërmjet vlerësimit të limituar mjedisor dhe social.

Gjithashtu, një projekt mund të kategorizohet si “NF” nëse struktura e financimit përfshin dispozitat e financimit nëpërmjet Ndërmjetësimit Financiar (NF) përmes së cilës NF ndërmerr detyrën e vlerësimit dhe monitorimit të nënprojektit.

#### *Projektet e Kategorisë A*

Në Projektin e Qyteteve të Gjellbra, projekte të kategorisë A përfshijnë: procesimin e mbetjeve dhe instalimet e hedhjes për djegie, përpunimin kimik ose landfill të mbetjeve kërcënuese, toksike ose të rrezikshme, instalime të mëdha për hedhjen e mbetjeve për djegie ose trajtimin me kimikate të mbetjeve jo të rrezikshme, impiantet bashkiake për përpunimin e ujërave të zeza me një kapacitet që kalon popullsinë prej 150,000 banorësh, strukturat bashkiake të mëdha për përpunimin e mbetjeve të ngurta dhe depozitimin e tyre. Gjithashtu, aktivitete të tilla mund të kategorizohen si I1, të përcaktuara nga FQGJ si “Kur një portofol ekzistues ose i propozuar i një Ndërmjetësi përfshin ose pritet të përfshijë një ekspozim të madh financiar ndaj aktiviteteve me risqe të mundshme jo të favorshme mjedisore dhe /ose sociale dhe/ose kur ndikimet janë të ndryshme, të pakthyeshme dhe të paregjistruara”.

Projektet e kategorizuara si A ose I1 do t'i përmbahen një procesi miratimi shumëpalësh nga BERZH dhe Bordi i FQGJ. Të gjithë nën projektet e Kategorisë A të përfshirë në Projektin e Qyteteve të Gjellbra do të kërkojnë miratim nga Bordi i Drejtorëve të BERZH, në vijim të përgatitjes së publikimit të dokumenteve të VNMS për të siguruar që projekti i përmbush Kriteret e Performancës së BERZH, kërkesat e shpalljes publike të detajuara më poshtë dhe risqet e mundshme mjedisore dhe sociale të projektit të identifikohen në mënyrën e duhur, të merren masa lehtësuese dhe të zgjidhen. Kjo do të mundësojë që të gjithë nën projektet e kategorisë A përmbushin vlerësimin mjedisor dhe social të FQGJ, angazhimin e palëve të interesuara dhe kërkesat e publikimit.

#### *Projektet e Kategorisë B dhe C*

BERZH kërkon një miratim të plotë nga Bordi i FQGJ për projektet që kategorizohen si B ose C. Këto projekte nuk do të kërkojnë të sillen në Bordin e FQGJ për një vlerësim të mëtejshëm dhe miratim dhe do të miratohen nëpërmjet proceseve të vendosura nga BERZH dhe do të zbatohen në përputhje strikte me Kuadrin e Qëndrueshmërisë Mjedisore dhe Sociale. Projekteve do t'u kërkojë të përmbushin Kriteret e Performancës së Bankës dhe kërkesat e shpalljes publike të detajuar më poshtë.

## **7. Vlerësimi Mjedisor dhe Social**

### **7.1 Përcaktimi i qëllimit dhe përmbajtjes së vlerësimit mjedisor dhe social**

Vlerësimi mjedisor dhe social i BERZH përfshin marrjen në konsideratë të këtyre tre elementeve: (i) ndikimet mjedisore dhe sociale dhe çështjet që lidhen me projektin, (ii) kapaciteti dhe

angazhimi i klientit për të zbatuar projektin ne përputhje me KP përkatëse dhe (iii) në shkallën e duhur pajisjet dhe aktivitetet që lidhen me projektin, por që nuk financohen nga BERZH. Qëllimi i vlerësimit mjedisor dhe social të BERZH-it do të përcaktohet rast pas rasti nëpërmjet përzgjedhjes dhe kategorizimit të procesit të përshkruar me lart nga Departamenti Mjedisor dhe i Qëndrueshmërisë (DMQ) së BERZH. Qëllimi dhe përmbajtja e DDMS, publikimi i informacionit, dhe kërkesat e angazhimit të palëve të interesuara janë në përpjesëtim me risqet e mundshme mjedisore dhe sociale, problematikat dhe ndikimet që lidhen me projektin. Për projekte me risk me të lartë dhe komplekse në aspektin mjedisor dhe /ose social, DMQ mund të vendosë që të përgatitet një plan DDMS i formalizuar dhe Termat e Referencës ("TeR").

Projektet e kategorisë A do të kërkojnë një Vlerësim të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) gjithëpërfshirës, i cili do të përfshijë një shpallje publike të formalizuar e pjesëmarrëse dhe një proces konsultimi. Procesi i VNMS fillon me një fazë studimi për të identifikuar ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale në të ardhmen nga projekti. VNMS do të përfshijë gjithashtu një analizim të alternativave të mundshme teknike dhe financiare në burim të këtyre ndikimeve duke përfshirë edhe alternativat pa projektin dhe dokumentimin e arsytimit për përzgjedhjen e planit të veprimit të propozuar. Gjithashtu do të identifikojë mundësi për përmirësime të mundshme dhe rekomandojë masat që nevojiten për të shmangur ose aty ku shmangia nuk është e mundur të minimizohen dhe lehtësohen ndikimet me efekt të pafavorshëm. VNMS mund të nevojitet të kryhet ose të verifikohet nga ekspertë të pavarur. Procesi i VNMS do të përfshihet në një Plan Menaxhimi Mjedisor dhe Social ("PMMS"), Plan Angazhimi të Palëve të Interesuara ("PAPI") dhe ku është e përshtatshme një Plan Veprimi të Shpërnguljes ("PVSH"), Plan Menaxhimi për Biodiversitetin ("PMB") ose Plan Menaxhimi për Trashëgiminë Kulturore ose plane menaxhuese të tjera specifike.

Projektet e Kategorisë B kërkojnë një vlerësim mjedisor dhe social që është ne përpjesëtim me natyrën e projektit, përmasat dhe vendndodhjen si edhe karakteristikat e risqeve dhe ndikimeve të mundshme. Vlerësimi do të përcaktojë ndikimet e mundshme jo të favorshme në të ardhmen që lidhen me projektin, do të identifikojë mundësitë e mundshme për përmirësim dhe rekomandojë masat që nevojiten për të shmangur ose kur nuk është e mundur shmangia, minimizimin dhe lehtësimin e ndikimeve jo të favorshme.

Për Projektet (Kategoritë A dhe B) të cilat përfshijnë objekte ekzistuese, kërkohet një vlerësim i çështjeve mjedisore dhe sociale të operacioneve të mëparshme dhe aktuale. Qëllimi i këtij vlerësimi është identifikimi i risqeve të mundshme, detyrimeve dhe mundësive që kanë të bëjnë me objektet dhe operacionet ekzistuese, për të konfirmuar situatën aktuale të Përputhshmërisë rregullatore dhe për të vlerësuar sistemet aktuale menaxhuese të klientit dhe performancën në përgjithësi kundrejt KP-ve. Çdo investigim i objekteve ekzistuese do të duhet të kryhet nga ekspertë të pavarur.

## **7.2 Rishikimi i informacionit ekzistues**

DDMS fillon me identifikimin dhe rishikimin e informacionit përkatës mjedisor dhe social ne lidhje me projektin. Një informacion i tillë përcaktohet nga Stafi Drejtues dhe/ose DQM së bashku me klientin.

## **7.3 Vizitat ne vendndodhje**

Në varësi të llojit të projektit dhe informacionit të marre nga klienti, DQM mund të kërkojë vizitë në vendndodhjen e projektit në fazën fillestare të kujdesit të duhur për të përcaktuar qëllimin dhe përmbajtjen e detajuar të DDMS. Për këto vizita do të përcaktohen objektiva specifike.

#### **7.4 Komisionimi i vlerësimit mjedisor dhe social**

Klienti është përgjegjës të sigurojë që vlerësimi mjedisor dhe social të përputhet me KP dhe t'i sigurojë Bankës informacionin e mjaftueshëm për të ndërmarrë një vlerësim mjedisor dhe social. Roli i DQM është të ndihmojë klientin me këtë detyrë dhe të këshillojë mbi qëllimin dhe përmbajtjen e studimeve të "kujdesit të duhur" që kërkohen për të përmbushur KP.

Vlerësimi mjedisor dhe social pritet të behet kryesisht nga konsulentë të pavarur ose ekspertë që i përkasin një pale të tretë. Në disa raste, projekti ose klienti mund të kenë një staf të specializuar në kompani ose konsulentë të mëparshëm që mund të kryejnë punën e nevojshme. Në disa situata të veçanta, Banka mund të vendosë që vlerësimi mjedisor dhe social i një projekti mund të ndërmerret nga specialistë të brendshëm mjedisor dhe social të Bankës.

### **8. Planet Vepruese të Menaxhimit Mjedisor dhe Social**

Klienti kërkohet të marrë në konsideratë rezultatet e procesit të vlerësimit mjedisor dhe social dhe përfundimet e angazhimit të palëve të interesuara në mënyrë që të zhvillojë dhe zbatojë një program me veprime për të adresuar ndikimet dhe problemet e identifikuara mjedisore dhe sociale të projektit si edhe të përcaktojë masat e përmirësimit të performancës për të përmbushur KP.

Në varësi të projektit, programi mund të konsistojë në kombinimin e politikave operationale të dokumentuara, sistemeve menaxhuese, procedurave, planeve, praktikave dhe investimeve të kapitalit të cilat së bashku njihen si Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social ("PMMS"). Përbërësit e programeve ose planeve të tilla mund të përfshijnë p.sh një Plan Veprimi Biodiversiteti, Plan Reagimi Emergjence, Plan Veprimi të Shpërnguljes, Kuadër të Restaurimit të Jetesës, Plan Zhvillimi për Popullsinë Indigjenë, Plan Veprimi të Drejtave Njerëzore, Plan Angazhimi të Palëve të Interesit dhe /ose plane të tjera specifike. Në mënyrë alternative, këto mund të jenë dokumente më vete.

Në rastet kur projekti nuk i përmbush KP të përcaktuara, klienti dhe Banka përveç PMMS duhet të arrijnë një marrëveshje mbi PVMS, i cili do të përfshijë masa të realizueshme nga ana teknike dhe financiare dhe masa me kosto efektive që projekti të arrijë përputhshmërinë me KP brenda një afati kohor të pranueshëm për BERZH. PVMS është mjeti kryesor që duhet për strukturimin e projekteve që të përmbushin KP si edhe një instrument i rëndësishëm për monitorimin e performancës së vazhdueshme mjedisore dhe sociale të projektit nga ana e BERZH. Gjithashtu, PVMS mund të përfshijë masa për klientin që të menaxhojë risqet mjedisore dhe sociale dhe /ose të përmirësojë praktikën e tij në përputhje me KP në aktivitetet e tij të tjera që janë të lidhura por jo pjesë e projektit (shih paragrafin 37 të PMS dhe 17-20 të KP 1).

Nëse nuk identifikohen veprime korrigjuese në vlerësimin mjedisor dhe social, nuk do të kërkohet një PVMS.

## **9. Rolet dhe përgjegjësitë për Menaxhimin e Kritereve Mjedisore dhe Sociale**

### **9.1 Roli dhe përgjegjësitë e Klientëve të BERZH**

Banka pret që klientët e saj të administrojnë çështjet mjedisore dhe sociale që lidhen me projektet për të përmbushur KP Brenda një periudhe kohë të arsyeshme. Projektet që përfshijnë struktura ose aktivitete biznesi të reja do të planifikohen që të përmbushin KP që në fillim. Nëse projekti përfshin struktura ekzistuese ose aktivitete që nuk përmbushin KP në kohën e miratimit nga Bordi, klienti do të kërkohet që të ndërmarrë masa të pranueshme për BERZH, që janë teknikisht dhe financiarisht të realizueshme dhe me kosto efektive për të arritur një përputhje të këtyre strukturave dhe aktiviteteve me KP brenda një periudhe kohe të pranueshme nga BERZH. Për më tepër, BERZH do të bashkëpunojë me klientët e saj për administrimin e risqeve mjedisore dhe sociale në përputhje me KP në veprimtaritë e tjera të tyre që janë të lidhura por jo pjesë të projektit.

Është gjithashtu përgjegjësi e klientit që të japë informacionin e mjaftueshëm në mënyrë që Banka të mund të ndërmarrë një vlerësim mjedisor dhe social në përputhje me PMS. Klientit mund t'i kërkohet të kryejë studime të përshtatshme mjedisore dhe sociale, të kryejë një angazhim të palëve të interesuara dhe të mbulojë kostot e tyre. Gjithashtu, klienti pritët t'i lejojë përfaqësuesit të BERZH dhe konsulentët e pavarur të kenë të drejta hyrjeje në strukturat dhe të dhënat e projektit. Gjithashtu, roli i klientit përfshin rënien dakord me Planin e Veprimit Mjedor dhe Social ("PVMS") dhe me përmbajtjen e informacionit mjedisor dhe social në Dokumentin Përmbledhës të Projektit ("DPP").

### **9.2. Roli dhe përgjegjësitë e BERZH**

Përgjegjësitë e BERZH janë në përputhje me rolin e saj si një institucion ndërkombëtar financiar që siguron financime bankare për projektet nëpërmjet burimeve të BERZH të miratuara nga departamentet menaxhuese të saj dhe Bordi i Drejtorëve ose njësi të tjera të marrjes së vendimeve. Për sa i përket një investimi ose projekti bashkëpunimi teknik specifik, niveli i angazhimit të BERZH përcaktohet nga natyra dhe qëllimi i projektit, disponueshmëria e financimit nga donatorët si edhe rrethanat specifike të marrëdhënies dhe bashkëpunimit me klientin.

BERZH mund të shmangë financimin e një projekti vetëm për arsye mjedisore ose sociale. BERZH nuk do të financojë projekte të cilat në dijeninë e saj përfshijnë ose rezultojnë në dëbime të forcuara. Për më tepër, ka lloje të tjera aktiviteteve që BERZH nuk i financon në përputhje me Listën përjashtuese Mjedisore dhe Sociale të BERZH, të përfshira në Shtojcën 1 të kësaj Rregullore.

## **10. Angazhimi i Palëve të Interesuara**

BERZH vlerëson rendësinë e angazhimeve të hapura dhe transparente ndërmjet klientëve, punëtorëve dhe komuniteteve vendase që ndikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga projektet, e kur është rasti palëve të tjera të interesuara si një element të rëndësishëm të praktikave të mira ndërkombëtare (PMN) dhe përgjegjësisë sociale të korporatës. Një angazhim i tillë është gjithashtu një mënyrë për përmirësimin e qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale të projekteve.

Veçanërisht angazhimi efektiv i komunitetit, i përshtatur në llojin dhe natyrën e projektit, nxit një performancë mjedisore dhe sociale të qëndrueshme dhe të sigurt dhe mund të rezultojë në rezultate të përmirësuara financiare, sociale dhe mjedisore së bashku me rritjen e përfitimeve të komunitetit. Angazhimi i Palëve të Interesuara është i rëndësishëm për të ndërtuar marrëdhënie të konsoliduara përfituese dhe përgjegjëse të cilat janë thelbësore për një administrim të suksesshëm të çështjeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale të projektit. Për të qenë më shumë efektiv, angazhimi i Palëve të Interesuara duhet të fillojë në një fazë të hershme të ciklit të projektit.

Kriteri i Performancës Nr. 10 i Bankës, si pjesë e Politikës së gjerë Mjedisore dhe Sociale specifikon që të gjithë projektet të cilët kanë premisa të shkaktojnë ndikime jo të favorshme mjedisore dhe sociale dhe problematika në mjedis, ndaj punëtorëve ose komuniteteve lokale të cilat preken në mënyrë të drejtpërdrejtë nga projekti (Kategoria A), të identifikojnë dhe angazhohen me palët e interesuara si një pjesë e rëndësishme e Sistemit të Përgjithshëm Menaxhues Mjedisor dhe Social (SMMS), procesin e vlerësimit mjedisor dhe social të projektit dhe planin e menaxhimit mjedisor dhe social.

Projektet që kërkohen të plotësojnë KP10 do të duhet të kryejnë një angazhim të palëve të interesuara duke iu siguruar komunitetit lokal që ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga projekti dhe palëve të interesuara përkatës e mundësinë që të marrin informacion në kohën e duhur, të përshtatshëm, lehtësisht të aksesueshëm dhe të kuptueshëm, në mënyrë të përshtatshme nga ana kulturore dhe të çliruar nga manipulimet, ndërhyrjet, kufizimet dhe presioni. Më shumë informacion mbi KP10 mund të gjendet në Politikën Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it.

Për projektet të cilat mund të kenë ndikime jo të favorshme mjedisore dhe sociale, klientët pritet që të identifikojnë të gjithë palët e interesuara në projekt dhe të krijojnë një plan për të angazhuar palët e interesuara, si një pjesë e rëndësishme e procesit të vlerësimit. Konsultimi duhet të jetë kuptimplotë për të marrë në konsideratë pikëpamjet dhe shqetësimet e palëve të interesuara për planifikimin, zbatimin dhe funksionimin e projektit. Klienti do të identifikojë palët e interesuara që mund të ndikohen dhe/ose të jenë të interesuara në projekt, do të publikojë informacion të mjaftueshëm mbi ndikimet dhe çështjet që mund të lindin nga projekti dhe të angazhohet me palët përkatëse të interesuara, në përputhje me ndikimet e mundshme që lidhen me projektin dhe nivelin e shqetësimit.

Për projektet e Kategorisë A, klienti dhe Banka do t'i mundësojë publikut një dokument VNMS. Për projektet në sektorin privat, dokumentet e VNMS do të jenë të publikuara për një minimum prej 60 ditësh kalendarike përpara vlerësimit të projektit nga Bordi, për projektet e sektorit publik 120 dite kalendarike para marrjes në konsideratë nga Bordi. Dokumente të VNMS do të krijohen nga klientët dhe BERZH i vë në dispozicion pa asnjë koment ose miratim të nënkuptuar. Megjithatë, përpara publikimit, DQM duhet t'i konsiderojë dokumentet e VNMS të përshtatshme dhe të plota për qëllimin e procesit të konsultimit.

Për më tepër, KP-te e BERZH përmbajnë kërkesa specifike për konsultim mbi projektet që mund të rezultojnë në zhvendosje fizike dhe/ose ekonomike ose mund të ndikojnë Popullsinë Indigjene.

## 11. Mekanizmi i Zgjidhjes së Ankesave

BERZH kërkon që klientët e saj të jenë në dijeni dhe t'i u përgjigjen në kohën e duhur shqetësimeve të palëve të interesuara në lidhje me projektin. Për këtë qëllim, klienti duhet të krijojë një mekanizëm, proces ose procedura të efektshme për ankesat, për të lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve të palëve të interesuara dhe ankesat e tyre, veçanërisht për performancën mjedisore dhe sociale të klientit. Mekanizmi i ankesave duhet të përshkallëzohet sipas risqeve dhe ndikimeve të mundshme jo të favorshme të projektit:

- Procesi ose procedurat e mekanizmit të ankesave duhet të adresojnë shqetësimet në mënyrë të menjëhershme dhe të efektshme, në mënyrë transparente që është e përshtatshme nga ana kulturore për t'u marrë në mënyrë të gatshme nga të gjitha segmentet e komuniteteve të ndikuara pa asnjë kosto dhe pa asnjë shkelje. Mekanizmi, procesi ose procedurat nuk duhet të pengojnë kompensimet e ligjshme ose administrative. Klienti duhet të informojë komunitetin e ndikuar mbi procesin e ankesave gjatë zhvillimit të aktiviteteve të tij të angazhimit me komunitetin dhe t'i raportojë në mënyrë të rregullt publikut mbi zbatimin e projektit duke mbrojtur privatësinë e individëve të ndikuar; dhe
- Mbajtja e një procesi ankesash duhet të bëhet në një mënyrë të përshtatshme kulturore dhe të qartë, objektive, të kujdesshme dhe të përgjegjshme ndaj nevojave dhe shqetësimeve të palëve të interesuara. Gjithashtu, mekanizmi duhet të lejojë paraqitjen dhe marrjen në konsideratë të ankesave anonime.

Gjithashtu, BERZH ka krijuar një mekanizëm mbi përgjegjësinë e vet, Mekanizmin e Ankesave për Projektin (MAP) që është krijuar për të vlerësuar dhe rishikuar ankesat mbi projektet e financuara nga Banka. Ky mekanizëm iu siguron individëve dhe grupeve vendase që mund të ndikohen direkt ose në mënyrë të pafavorshme nga një projekt i BERZH-it si edhe organizatave të shoqatave civile, një mënyrë për t'i paraqitur Bankës ankesa dhe shqetësime, në mënyrë të pavarur nga veprimtaria bankare.

MAP ka dy funksione:

- Funksionin e Rishikimit të Ankesave i cili kërkon të vlerësojë nëse një projekt i miratuar nga Banka përputhet me politikat përkatëse të BERZH-it, veçanërisht me politikat përkatëse mjedisore dhe dispozitat specifike të projektit të Politikës së Informimit Publik, dhe
- Një Nismë mbi Zgjidhjen e Problemeve e cila ka synim të rivendosë dialogun ndërmjet palëve, ku është e mundur, të mundohet të zgjidhë çështjet thelbësore që mund të shkaktojnë pakënaqësi dhe ankesa. Një nismë mbi zgjidhjen e problemit mund të përfshijë një mënyrë të pavarur për të kërkuar fakte, ndërmjetësim, pajtim, lehtësim dialogu, investigim ose raportim.

Në vijim të vlerësimit të një ankese, mund të ketë një rekomandim për një rishikim përputhshmërie edhe/ose Nisme për Zgjidhjen e Problemit, ose asnjëra.

## 12. Monitorimi

Politika Mjedisore dhe Sociale dhe Procedurat Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it parashtrojnë metodën dhe procesin për monitorimin e performancës Mjedisore dhe Sociale të investimeve të saj duke u bazuar në ndjekjen e zbatimit të Kritereve të Performancës. Kjo përfshin kryerjen e aktiviteteve monitoruese nga klientët tanë, dhe monitorim të kryer nga stafi i BERZH nëpërmjet shqyrtimit të raporteve të marra, vizitave në vend dhe monitorimin nga palë të treta. Aktivitetet monitoruese për çdo projekt përcaktohen mbi bazën e risqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale që lidhen me projektin dhe janë identifikuar gjatë zhvillimit të vlerësimit mjedisor dhe social. Gjithashtu ato mund të reflektojnë shqetësime thelbësore të palës së interesuar dhe të përfshijnë një auditim ose një shqyrtim përfundimi social të projektit, kur është e aplikueshme. Minimalisht, kërkesat dhe angazhimet për monitorim do të përfshijnë shqyrtime të Raporteve Vjetore Mjedisore e Sociale të përgatitura nga klientët për projektet. Gjithashtu BERZH mund të verifikojë në mënyrë periodike informacionin mbi monitorimin e përgatitur nga klientët nëpërmjet vizitave në vend të kryera nga specialistët mjedisorë e sociale dhe/ose ekspertë të pavarur.

Nëse klienti nuk arrin të përmbushë angazhimet e tij sociale dhe mjedisore, të përcaktuara në marrëveshjet ligjore, BERZH mund të vendosë me klientin që të ndërmerren masat rregulluese prej tij për të arritur përputhshmërinë. Nëse klienti nuk arrin të plotësojë masat rregulluese të miratuara, Banka mund të ndërmarrë një veprim dhe/ose të zbatojë masa rregulluese që janë pjesë e marrëveshjeve financiare të cilat i konsideron të përshtatshme. Gjithashtu, BERZH do të rishikojë me klientin çdo mundësi për përmirësimin e performancës që lidhet me projektin.

### **13. Shtojcat**

- Lista përjashtuese (Lista e aktiviteteve që programi nuk do të financojë)
- Lista Ekzaminuese
- Skica e Planit të Angazhimit të Palëve të Interesuara

## Nën-shtojca 1:Lista e përjashtimeve Mjedisore dhe Sociale të BERZH

BERZH nuk do të financojë me dijeninë e saj projekte që përfshijnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë aktivitetet e mëposhtme:

- (a) Prodhimin ose tregtimin e çdo produkti ose aktivitet të konsideruar të paligjshëm sipas ligjeve ose rregullave të shtetit pritës (kombëtare), marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare, ose pjesë të ndalimeve ose përjashtimeve ndërkombëtare si më poshtë:
  - (i) Prodhimin ose tregtimin e një produkti që përmban DP.<sup>7</sup>
  - (ii) Prodhimin ose tregtimin të produkteve farmaceutike, pesticideve/herbicideve dhe substancave të tjera të rrezikshme që janë pjesë e ndalimeve ose përjashtimeve ndërkombëtare.<sup>8</sup>
  - (iii) Prodhimin ose tregtimin e substancave të dëmtimit të ozonit që janë pjesë e ndalimeve ndërkombëtare.<sup>9</sup>
  - (iv) Tregtimin e specieve të egra ose prodhimin e produkteve të tyre e përcaktuar nën KTNSRR.<sup>10</sup>
  - (v) Lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve të ndaluara nga ligjet ndërkombëtare.<sup>11</sup>
- (b) Prodhimin ose përdorimin për tregti të fibrave të palidhura të asbestit ose produkteve që përmbajnë asbest.
- (c) Aktivitetet e ndaluara nga legjislacioni i vendit pritës ose konventat ndërkombëtare që lidhen me mbrojtjen e burimeve të biodiversitetit ose trashëgimisë kulturore.<sup>12</sup>
- (d) Peshkimin me rrjeta në mjedis detar duke përdorur rrjeta me një gjatësi që tejkalon 2.5 km.
- (e) Transportimin e naftës ose substancave të tjera të rrezikshme në depozita që nuk përputhen me kriteret e IMO.<sup>13</sup>

<sup>7</sup>DP: Dyfenil i Polikronizuar janë një grup kimikatesh me përmbajtje të madhe toksike. DP kanë shumë mundësi të gjenden në transformatorët e mbushur me vajra, kondensatorët, dhe mekanizmat e viteve 1950-1985.

<sup>8</sup>Dokumentet e referencës janë Rregullat e Këshillit (EEC) Nr 2455/92 e datës 23 korrik 1992 në lidhje me Eksportin dhe Importin e Disa Kimikateve të Rrezikshme, e ndryshuar vazhdimisht; Lista e Produkteve e Konsoliduar e Kombeve të Bashkuara ku Konsumimi dhe /ose Shitja e të cilave është e ndaluar, tërhequr dhe e limituar ose e nuk është e miratuar nga Qeveritë; Konventa mbi Procedurat që kërkojnë një Miratim dhe Informim Paraprak mbi disa Kimikate të Rrezikshme në Tregtinë Ndërkombëtare (Konventa e Roterdamit); Stockholm Convention mbi Ndotësit Organike të Vazhdueshëm; Klasifikimi i Rekomanduar nga Organizata Ndërkombëtare e Shëndetit i Pesticideve të Rrezikshme.

<sup>9</sup>Substanca që Dëmtojnë Ozonin (SDO): Janë përbërës kimike që ndikojnë dhe shkatërrojnë shtresën e ozonit, duke shkaktuar “vrimat e ozonit”. Protokollit i Montrealit mbi Substancat që Dëmtojnë Shtresën e Ozonit i liston SDO-të dhe data të ndalimit të tyre. Një listë mbi përbërësit kimikë të Protokollit të Montrealit që përfshin, aerosolet, ngritësit, agjentë që shkaktojnë shkumë, tretës dhe agjente ndaj mbrojtjes nga zjarri së bashku me një listë të shteteve dhe datat për daljen nga funksioni, mund të gjendet në Programin Mjedisor të Kombeve të Bashkuara.

<sup>10</sup>KTNSRR: Konventa mbi Tregtinë Ndërkombëtare mbi Speciet e Rrezikuara të Faunës dhe Florës së Egër. Një listë mbi speciet e listuara mund të gjendet në sekretariatin e KRNSRR.

<sup>11</sup> Dokumentet e Referencës janë: Rregullorja (BE) Nr 1013/2006 e datës 14 Qershor 2006 mbi transferimin e mbetjeve; Vendimi C(2001)107/Final i Këshillit të OECD në lidhje me Rishikimin e Vendimit C(92)39/Final, mbi kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të destinuara për veprimtari për punimi; Konventa e Bazelit mbi Kontrollin e Lëvizjeve Ndërkufitare të Mbetjeve të rrezikshme dhe Depozitimin.

<sup>12</sup> Konventat përkatëse Ndërkombëtare përfshijnë: Konventën mbi Ruajtjen e Specieve Migruese të Kafshëve të Egra (Konventa e Bonit); Konventa mbi Truallet ligatina me Rëndësi Ndërkombëtare, veçanërisht Habitati në këto Trualle (Konventa Ramsar); Konventa mbi ruajtjen e Jetës së Egër dhe Habiteteve Natyrore në Evropë (Konventa e Bernës). Konventa në Lidhje me Mbrojtjen e Kulturës Botërore dhe Trashëgimive Natyrore; Konventa mbi Diversitetin Biologjik,

<sup>13</sup>Këtu përfshihen: depozitat që nuk përmbushin Konventa Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjeve nga Anijet (KNPNA), certifikatat e Konventës Ndërkombëtare mbi Sigurinë e Jetës në Det (KNSJD) (ku përfshihen pa limitime të gjitha kriteret e Kodit të Menaxhimit Ndërkombëtar të Sigurisë), anijet cisterne të ndaluara nga Bashkimi Europian ose të ndaluara nga Memorandumi i Mirëkuptimit në Paris (Paris MIM) dhe anijet cisterne që kanë kaluar fazën e rregullave të MARPOL 13G. Asnjë anije cisternë më shumë se 25 vjet nuk duhet të përdoret.

- (f) Tregtimin e produkteve pa licencat përkatëse të eksportit ose importit ose pa vërtetime autorizimi për kalim transit në shtetet përkatëse për eksport, import dhe transit kur është e aplikueshme.

## Nën-shtojca 2: Lista ekzaminuese

### Hyrje

Përmbledhja e Përputhshmërisë ka një listë ekzaminuese për një rishikim sistematik për të identifikuar ndikimet dhe risqet mjedisore dhe sociale ne përputhje me Politiken Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it, siç përcaktohet nëpërmjet Kriteve të Performancës që aplikohen. Qëllim i Përputhshmërisë janë të gjitha KP që aplikohen ne projektet që nuk janë IF. Rishikimi mendohet të sigurojë një bazë ku mund të hetohet performanca e ardhshme e projekteve nëpërmjet një procesi raportimi vjetor mjedisor dhe social.

### Udhëzime

Për të gjitha KP (Me tregues reference me numra të plotë), sigurojnë një përmbledhje të Përputhshmërisë se përgjithshme me KP. Justifikimi për çdo devijim nga një KP duhet të përmbledhet dhe të dokumentohet me materiale mbështetëse.

Për çdo tregues brenda një KP, ju lutem plotësoni 3 hapat e mëposhtëm:

- 1. Vendosni nëse treguesi është i aplikueshëm.** Për projektet e Kategorisë A dhe B, pika fillestare është që të gjithë treguesit janë të aplikueshëm vetëm nëse projekti nuk ka aspekte të rëndësishme në lidhje me treguesin (p.sh. nuk ka risqe), dhe në këtë rast treguesi do të vlerësohet me "JA" dhe me një përmbledhje të shkurtër mbi arsyetimin që jepet. Për projektet e Kategorisë C, pika fillestare është që të gjithë treguesit janë JA, vetëm nëse projekti ka një aspekt të rëndësishëm në lidhje me një tregues (p.sh. ka një risk material).
- 2. Vendosni nëse një opinion është i mundur.** Nëse jo (p.sh. nëse treguesi aplikohet, por është shumë herët në projekt), vlerësoni me "POM" dhe jepni një përmbledhje për arsyen. Atje ku mungesa e opinionit përfaqëson heqje të materialit të përshkrimit, tregoni se ku tregohet kjo në raport dhe përmbledhni ndonjë rekomandim.

### 3. Vlerësoni treguesit si më poshtë dhe jepni një shpjegim të shkurtër

|    |                                                                                                                                                                                                                                        |
|----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| EC | <b>Tejkalon përputhshmërinë</b><br>Projekti i tejkalon kërkesat dhe pritshmëritë e KP të BERZH. BERZH duhet të jete në gjendje t'i përdorë projektet e kategorizuara EC si projekte model për ndikimet pozitive Mjedisore dhe Sociale. |
| FC | <b>Përputhshmëri e Plotë</b><br>Projekti është në përputhshmëri të plotë me kërkesat e BERZH, udhëzimet dhe politikat vendase mjedisore, shëndetësore dhe të sigurisë së BE.                                                           |
| PC | <b>Përputhshmëri të Pjesshme</b><br>Projekti nuk është në përputhshmëri të plotë me kërkesat e BERZH-it, por ka vendosur sisteme, procese ose masa lehtësuese, të cilat do të veprojnë për të adresuar mangësitë.                      |
| MN | <b>Mospërputhje Materiale</b><br>Projekti nuk është në përputhje me kërkesat e BERZH-it dhe sistemet, proceset dhe masat lehtësuese që ka vendosur nuk veprojnë për adresimin e mangësive.                                             |

- Komente/Probleme:** Përgatitni një seksion komentues të shkurtër mbi përkatësinë e këtij kriteri për projektin dhe jepni një shpjegim mbi vlerësimin e dhënë.
- Veprimet që kërkohen:** Atje ku është e aplikueshme, përshkruani shkurt veprimet që nevojiten të ndërmerren nga klienti për të pasur një përputhshmëri të plotë të çdo kriteri. Kur një veprim përkatës përfshihet në PVMS e këtij projekti, ju lutem tregoni ku i referohet PVMS.
- Përmbledhje e KP:** Siguroni një përmbledhje të përgjithshme në lidhje me KP, duke përdorur përcaktimet e Përputhshmërisë së mësipërme me komente mbështetëse. Në disa raste, mund të jetë e mjaftueshme të të përmendet një KP vetëm në nivelin përmbledhës, në varësi të Fazës 1 më lart.

**Shënim:** Vlerësimi i Mospërputhjes Materiale (si në nivelin Tregues edhe në atë të KP) ka pasoja të rëndësishme në procesin e miratimit të Projektit dhe ka nevojë për një kujdes të veçantë. Në gjykimin nëse masat zgjidhin mjaftueshëm mangësitë, konsulenti duhet të konsiderojë në mënyrë të strukturuar nivelin e riskut të mbetur (pas miratimit) dhe nivelin e sigurisë që Projekti mund ta trajtojë çështjen në përputhje me Politikën nëpërmjet PVMS. Tabela më poshtë ilustron qëndrimin që duhet të mbahet.

|       |         |    |    |    |
|-------|---------|----|----|----|
| Risku | I lartë | PC | MN | MN |
|       | Mesatar | PC | PC | MN |
|       | I Ulët  | FC | PC | PC |

|         |         |        |
|---------|---------|--------|
| I Lartë | Mesatar | I ulët |
|---------|---------|--------|

Siguria

| KPI Ref. | Kriteri i Performancës                                                         | Vlerësimi | Komente/ Çështje | Veprimi i Kërkuar | PVMS Ref. |
|----------|--------------------------------------------------------------------------------|-----------|------------------|-------------------|-----------|
| 1        | <b>Vlerësimi dhe Menaxhimi i Çështjeve dhe Ndikimeve Mjedisore dhe Sociale</b> |           |                  |                   |           |
|          | <b>Përmbledhje:</b>                                                            |           |                  |                   |           |
| 1.1      | Vlerësimi Mjedisor dhe Social                                                  |           |                  |                   |           |
| 1.2      | Sistemet e Menaxhimit Mjedisor dhe Social                                      |           |                  |                   |           |
| 1.3      | Politika Mjedisore dhe Sociale <sup>14</sup>                                   |           |                  |                   |           |
| 1.4      | Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social                                         |           |                  |                   |           |
| 1.5      | Kapaciteti Organizativ dhe Angazhimi                                           |           |                  |                   |           |
| 1.6      | Menaxhimi i Rrjetit Furnizues                                                  |           |                  |                   |           |
| 1.7      | Monitorimi i Projektit dhe Raportimi <sup>15</sup>                             |           |                  |                   |           |

<sup>14</sup> Kur projekti përfaqëson një zgjatje të konsiderueshme të aktiviteteve të klientit, konfirmoni që Politika dhe Planet dhe sistemet menaxhuese mbështetëse janë të përshtatshme për aktivitete të reja.

<sup>15</sup> Në fazën e vlerësimit do të ketë informacion të limituar. Vlerësimi i përputhshmërisë duhet të ketë plane specifike për monitorimin dhe raportimin (sipas kriterëve të PNMS) dhe gjithashtu të konsiderohet nëse ka fakte për raportim/monitorim të dobët nga klienti në projekte të tjera – të cilat mund të ulin besueshmërinë për performancën në të ardhmen.

| KPI Ref. | Kriteri i Performancës                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | Vlerësimi | Komente/ Çështje | Veprimi i Kërkuar | PVMS Ref. |
|----------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|------------------|-------------------|-----------|
| 2        | <b>Kushtet e Punës</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |           |                  |                   |           |
|          | <b>Përmbledhje:</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |           |                  |                   |           |
| 2.1      | Politikat e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve të Punës                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |           |                  |                   |           |
| 2.2      | Puna e Detyruar dhe e Fëmijëve                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |           |                  |                   |           |
| 2.3      | Mundësitë e Njëjta dhe jo-Diskriminuese                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |           |                  |                   |           |
| 2.4      | Organizatat e Punonjësve                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |           |                  |                   |           |
| 2.5      | Pagat, përfitimet, kushtet e punës dhe strehimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |           |                  |                   |           |
| 2.6      | Shkurtime <sup>16</sup>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |           |                  |                   |           |
| 2.7      | Mekanizmi i Ankesave                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |           |                  |                   |           |
| 2.8      | Punëtorët Jo-Punonjës                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |           |                  |                   |           |
| 2.9      | Rrjeti i Furnizimit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |           |                  |                   |           |
| 2.10     | Kriteret mbi Sigurinë e personelit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |           |                  |                   |           |
| 3        | <b>Efektshmëria e Burimeve dhe Kontrolli dhe Parandalimi i Ndotjeve</b><br><i>Shënim – Vlerësimi duhet të konsiderojë në mënyrë të kujdesshme dhe të përmendë se cilat rregulla ose standarde janë aplikuar në përputhje me vlerësimin (p.sh BE, Kombëtare, Praktikë më të Mira në Sektor). Vlerësimet duhet t'i kushtojnë konsideratë performancës së teknikave alternative.</i> |           |                  |                   |           |
|          | <b>Përmbledhje:</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |           |                  |                   |           |
| 3.1      | Efektshmëria e Burimeve                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |           |                  |                   |           |
| 3.2      | Parandalimet e Ndotjes dhe Kontrolli i Çlirimit në Ajër                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |           |                  |                   |           |

<sup>16</sup> Nuk do të aplikohet në shumë projekte në fazën e vlerësimit. Megjithatë, faktet, brenda tre vjetëve të fundit të sjelljes së klientit mbi shkurtime e cila nuk përputhet me Politikën nuk do të merren në konsideratë.

| KPI Ref. | Kriteri i Performancës                                   | Vlerësimi | Komente/ Çështje | Veprimi i Kërkuar | PVMS Ref. |
|----------|----------------------------------------------------------|-----------|------------------|-------------------|-----------|
| 3.3      | Parandalimi i Ndotjes dhe Kontrolli i Ujërave të mbetura |           |                  |                   |           |
| 3.4      | Gazet e Efektit Serë <sup>17</sup>                       |           |                  |                   |           |
| 3.5      | Uji                                                      |           |                  |                   |           |
| 3.6      | Mbetjet                                                  |           |                  |                   |           |
| 3.7      | Materiale dhe Substanca të Rrezikshme                    |           |                  |                   |           |
| 4        | <b>Shëndeti dhe Siguria</b>                              |           |                  |                   |           |
|          | <b>Përmbledhje:</b>                                      |           |                  |                   |           |
| 4.1      | Shëndeti dhe Siguria Profesionale                        |           |                  |                   |           |
| 4.2      | Shëndeti dhe Siguria e Komunitetit                       |           |                  |                   |           |
| 4.3      | Infrastruktura, Ndërtesa, Plani i Pajisjeve dhe Siguria  |           |                  |                   |           |
| 4.4      | Siguria nga Materialet e Rrezikshme                      |           |                  |                   |           |
| 4.5      | Siguria e Produkteve dhe Shërbimeve                      |           |                  |                   |           |
| 4.6      | Siguria Rrugore dhe në Trafik                            |           |                  |                   |           |
| 4.7      | Rreziqet Natyrore                                        |           |                  |                   |           |
| 4.8      | Ekspozimi ndaj Sëmundjeve                                |           |                  |                   |           |
| 4.9      | Përgjigjja dhe Përgatitja ndaj Emergjencave              |           |                  |                   |           |

<sup>17</sup> Një vëmendje e veçantë do t'iu kushtohet klientëve që konsiderojnë alternativa zgjidhëse. Projektet që parashikohen të prodhojnë më shumë se një ekuivalent të 25,000 ton Co2, duhet të sigurojnë një inventar dhe plan të çlirimeve/derdhjeve për një raportim vjetor.

| KPI Ref. | Kriteri i Performancës                                                 | Vlerësimi | Komente/ Çështje | Veprimi i Kërkuar | PVMS Ref. |
|----------|------------------------------------------------------------------------|-----------|------------------|-------------------|-----------|
| 5        | <b>Marrja e Tokës, Shpërngulja e Detyruar dhe Zhvendosja Ekonomike</b> |           |                  |                   |           |
|          | <b>Përmbledhje:</b>                                                    |           |                  |                   |           |
| 5.1      | Shmangia dhe minimizimi i shpërnguljeve                                |           |                  |                   |           |
| 5.2      | Konsultimi                                                             |           |                  |                   |           |
| 5.3      | Kompensimi për shpërnguljet e personave                                |           |                  |                   |           |
| 5.4      | Mekanizmi i ankesave                                                   |           |                  |                   |           |
| 5.5      | Dokumentacioni RAP/LRP                                                 |           |                  |                   |           |
| 5.6      | Zbatimi RAP/LRP                                                        |           |                  |                   |           |
| 5.7      | Monitorimi                                                             |           |                  |                   |           |
| 6        | <b>Biodiversiteti dhe Burimet Natyrore të Gjallesave</b>               |           |                  |                   |           |
|          | <b>Përmbledhje:</b>                                                    |           |                  |                   |           |
| 6.1      | Vlerësimi mbi Biodiversitetin dhe Burimet Natyrore të Gjallesave       |           |                  |                   |           |
| 6.2      | Ruajtja e Biodiversitetit                                              |           |                  |                   |           |
| 6.3      | Menaxhimi i Qëndrueshëm i Burimeve Natyrore të Gjallesave              |           |                  |                   |           |
| 7        | <b>Popullsia Indigjene</b>                                             |           |                  |                   |           |
|          | <b>Përmbledhje:</b>                                                    |           |                  |                   |           |
| 7.1      | Vlerësimi i Popullsisë Indigjene                                       |           |                  |                   |           |

| KPI Ref. | Kriteri i Performancës                                                              | Vlerësimi | Komente/ Çështje | Veprimi i Kërkuar | PVMS Ref. |
|----------|-------------------------------------------------------------------------------------|-----------|------------------|-------------------|-----------|
| 7.2      | Shmangia e Ndikimeve të Pafavorshme dhe Plani i Zhvillimit për Popullsinë Indigjene |           |                  |                   |           |
| 7.3      | Publikimi i Informacionit, Konsultimi Thelbësor dhe Informimi i Pjesëmarrësve       |           |                  |                   |           |
| 7.4      | Mekanizmi i Ankesave dhe Parandalimi i Diskriminimit me bazë Etnike                 |           |                  |                   |           |
| 7.5      | Ndarja e Kompensimeve dhe Përfitimeve                                               |           |                  |                   |           |
| 7.6      | Ndikimet/Zhvendosjet në Tokat Tradicionale dhe Trashëgimitë Kulturore               |           |                  |                   |           |
| 8        | <b>Trashëgimia Kulturore</b>                                                        |           |                  |                   |           |
|          | <b>Përmbledhje:</b>                                                                 |           |                  |                   |           |
| 8.1      | Vlerësimi dhe Menaxhimi i Ndikimeve mbi Trashëgiminë Kulturore                      |           |                  |                   |           |
| 8.2      | Konsultimi me Komunitetet e Ndikuara dhe Palë të tjera të Interesuara               |           |                  |                   |           |
| 8.3      | Përdorimi nga projekti i Trashëgimisë Kulturore                                     |           |                  |                   |           |

| KPI Ref. | Kriteri i Performancës                                                 | Vlerësimi | Komente/ Çështje | Veprimi i Kërkuar | PVMS Ref. |
|----------|------------------------------------------------------------------------|-----------|------------------|-------------------|-----------|
| 10       | <b>Publikimi i Informacionit dhe Angazhimi i Palëve të Interesuara</b> |           |                  |                   |           |
|          | <b>Përmbledhje:</b>                                                    |           |                  |                   |           |
| 10.1     | Plani i Angazhimit të Palëve të interesuara                            |           |                  |                   |           |
| 10.2     | Mekanizmi Operacional i Ankesave                                       |           |                  |                   |           |
|          | <b>Përputhshmëria e Përgjithshme</b>                                   |           |                  |                   |           |
|          | Kërkesat Kombëtare Mjedisore, Sociale dhe Shëndetësore                 |           |                  |                   |           |
|          | Kriteret e BE Mjedisore, Sociale, Shëndetësore dhe të Sigurisë         |           |                  |                   |           |

### Nënshtojca 3: Udhëzimet për një Plan të Angazhimit të Palëve të Interesuara

Lista e mëposhtme është një listë treguese e çështjeve që mund të përfshihen në një Plan të Angazhimit të Palëve të Interesuara. Konsulenti pritët të përdorë gjykimin e tij profesional për të përcaktuar cilat çështje (të listuar më poshtë ose shtesë) mund të kenë lidhje me Projektin.

Një Plan i Angazhimit të Palëve të Interesuara do të duhet të:

- Identifikojë shkurtimisht vendndodhjen e Projektit dhe zonat që mund të ndikohen (p.sh listën e komuniteteve);
- Regjistrojë se çfarë i kërkohet ligjërisht projektit të kryejë në lidhje me publikimin dhe konsultimin;
- Identifikojë të gjitha palët e interesuara, duke përfshirë edhe hartat e palëve të interesuara (nëse është e mundur);
- Identifikojë grupet specifike të cilat mund të konsiderohen si të prekura ose që kanë nevojë për mbështetje në procesin e konsultimit, p.sh si rezultat i nivelit të edukimit, gjinisë, nivelit social-ekonomik, përbërjes etnike/gjuhës, ose vendndodhjes (p.sh afërsia e projektit me shkollat, spitalet etj). për çdo grup të identifikuar, specifikoni se sa thelbësor do të jetë konsultimi;
- Raporto një mbi aktivitetet e mëparshme konsultuese dhe publikuese;
- Përcaktojë se cilat dokumente do të publikohen duke përfshirë një program dhe në çfarë gjuhe;
- Të përcaktojë se ku mund të gjenden dokumentet (adresat fizike dhe online), si p.sh të jepen emrat specifike të gazetave, vendndodhjeve të shpalljes së buletineve, etj;
- Përcaktojë se si do të njoftohen njerëzit për disponueshmërinë e dokumentit;
- Përcaktojë datat e filmit dhe mbarimit të konsultimit;
- Përgatisë një tryezë ose listë takimesh, aktiviteteve ose mundësi për t'u angazhuar. Nëse vendndodhja dhe datat nuk dihen akoma, të përcaktohet se si njerëzit do të njoftohen mbi datat;
- Përcaktojë se te kush/ku do të dërgohen komentet, çfarë do të bëhet më tej me to dhe sesi njerëzit do të njoftohen mbi rezultatet;
- Përcaktojë se si do të menaxhohen ankesat (duke përfshirë një proces të veçantë të ankimimit publik);
- Përcaktojë aktivitetet monitoruese dhe raportuese për procesin e angazhimit të palëve të interesuara;
- Përcaktojë përgjegjësitë për kryerjen e një procesi të angazhimit të palëve të interesuara.

PAPI duhet të jetë i përqendruar dhe nuk duhet të kalojë 15 faqe, duke përfshirë shtojcat.

Gjithashtu shihni shënimet udhëzuese:

<http://www.ebrd.com/downloads/about/sustainability/grievance-mechanism.pdf>